

## STATUT

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### “LIFT GROUP” Sh.p.k.

#### *I. THEMELIMI*

##### **Neni 1** **Ortakja e Vetme**

1. **Znj. BORANA VANGJELI** shtetase shqiptare, e lindur në Permet, më 04/09/1987, mbajtëse e kartes se Identitetit nr. **I75904056R** madhore, me zotësi të plotë për të vepruar;

E cila, në cilësinë e ortakes themeluese të shoqërisë “**LIFT GROUP**” sh.p.k, vendos për të themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me këtë Statut:

#### *II. EMRI, FORMA E SHOQERISE, SELIA, KAPITALI*

##### **Neni 2** **Emri**

2.1 Emri i shoqërise është “**LIFT GROUP**” Sh.p.k., ketu me poshte e quajtur “**Shoqëria**”.

##### **Neni 3** **Forma ligjore**

3.1 Shoqëria është themeluar dhe organizuar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

3.2 Përgjegjësia e ortakëve shtrihet në përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë.

3.3 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar.

##### **Neni 4** **Baza ligjore**

4.1 Shoqëria, do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me Statutin dhe legjislacionin tregtar dhe ligjet e tjera të Republikës së Shqipërisë.

## **Neni 5**

### **Vula dhe logo**

- 5.1 Shoqëria do të ketë vulën dhe logon e saj. Administratori do të përdorë vulën.
- 5.2 Të gjitha dokumentet do të mbajnë vulën dhe logon e Shoqërisë.

## **Neni 6**

### **Kohezgjatja**

- 6.1 Kohezgjatja e Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore të pakufizuar.
- 6.2 Shoqëria do të fillojë veprimtarinë e saj me regjistrimin e saj në Qendren Kombëtare të Biznesit.

## **Neni 7**

### **Selia**

- 7.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Tiranë Rruga Mine Peza. Pallati 242, shk.1 Ap 4 Tiranë Shqipëri.
- 7.2 Shoqëria mund të krijojë degë të saj, filiale dhe zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 7.3 Shoqëria, mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera ekzistuese ose që mund të krijohen në të ardhmen në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 8**

### **Objekti**

- 8.1 Komunikim, Publicitet dhe Marketing; Teknologji inovative; Marketing dixhital, Aktivitet në fushën e reklamave, shtypshkrime, dizajn grafik, zhvillim brandi, web dizajn, zhvillim web dhe zhvillim aplikacionesh, shërbim fotografie, organizim eventesh, shtëpi kinematografike, prodhim dhe distribucion i filmave të zhanreve të ndryshme;
- 8.2 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

## **Neni 9**

### **Kapitali i Shoqërisë**

- 9.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 Lekë.

9.2 Kapitali i Shoqërisë do të ndahet në 1 (një) pjesë kapitali, me vlerë 100.000 Lekë.

9.3 Ortaku i vetëm zotëron 1 kuotë që përfaqëson 100 % të kapitalit të shoqërisë.

#### **Neni 10**

##### **Transferimi i pjesëve të kapitalit**

Transferimi i kuotave kryhet ne perputhje me legjislacionin per shoqerite tregrare. Kuotat mund të transferohen plotësisht ose pjesërisht te palët e treta.

### ***III. STRUKTURA DREJTUESE***

#### **Neni 11**

##### ***Vendimet e Ortakut të vetëm***

11.1 Vendimet më të rëndësishme në lidhje me aktivitetin e shoqërisë merren nga Ortaku i vetëm i cili është organi më i lartë i shoqërisë.

11.2 Asambleja e përgjithshme mund të thirret nga administratori ose nga ortaku i vetëm sipas procedurave të përcaktuara ne legjislacion. Asambleja ndër të tjera do të vendosë për çështjet e mëposhtme:

- a) Miratimin dhe ndryshimin e Statutit të Shoqërisë;
- b) Pranimin e ortakëve të rinj (pas zmadhimit të kapitalit fillestar, ose pas transferimit të kuotave);
- c) Zmadhimin ose/dhe zvogelimin e kapitalit dhe/ose ndonje pagese tjeter ose subvencione te ortakeve;
- d) Vendos per bashkim, riorganizimin, likuidim ose çdo lloj tjeter transformimi të shoqërisë;
- e) Vendos ne blerjen dhe/ose dorezimin e ofertave te interesimit ne shoqëri te ndodhura ne Shqipëri ose jashtë;
- f) Të përcaktoje buxhetin vjetor;
- g) Miratimin e deklaratave financiare vjetore dhe bilancet dhe te miratoje shpërndarjen e fitimeve;
- h) Të vendose per rregullat e brendshme te administrimit të Shoqërisë;
- i) Të ngreje padi kunder anetareve te organeve drejtuese te shoqerise;
- j) Të vendosë për të gjitha transaksionet në lidhje me pasuritë e paluajtshme të shoqërisë.
- k) Shpërndarjen e shoqërisë;
- l) Të përcaktoje shpërblimin e administratoreve;
- m) Të vendosë ne zgjedhjen e ekspertit kontabël;
- n) Të përcaktoje organizimin strukturor dhe administrativ të shoqërisë;

11.3 Për çështjet e renditura më sipër asambleja e përgjithshme vendos me shumicë te kualifikuar te votave të ortakëve, qe do te thote se asambleja e përgjithshme mund te marre

vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë ose me mjete elektronike.

## Neni 12

### *Administratori*

12.1 Administrator i Shoqërisë do të jetë: **Znj BORANA VANGJELI**, i dtl. 04/09/1987, mbajtës i ID **I75904056R** banuese në Tiranë

12.2 Administratori emërohet, zëvendësohet ose largohet nga Asambleja e Ortakëve.

12.3 Administratori mund të autorizojë persona të tretë nëpërmjet autorizimit ose prokurës ta përfaqësojnë atë në veprime të ndryshme.

12.4 Administratori do të organizojë dhe menaxhojë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ai është i autorizuar të përfaqësojë Shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të.

12.5 Të drejtat dhe detyrimet e administratorit burojnë nga ligji, Statuti, vendimet e ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.

12.6 Duke u kufizuar në pikat e nenit 11 më lart, administratori ka këto kompetenca:

- (a) përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe organeve shtetërore për kryerjen e të gjithave veprimeve, si regjistrimin e shoqërisë pranë QKB, regjistrimin pranë organeve tatimore, inspektoriatit të punës etj;
- (b) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
- (c) të marrë kredi në emër të shoqërisë dhe të vendosë për kushtet e kredisë;
- (d) të përfundojë marrëveshje për dhënie kredie;
- (e) përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
- (f) nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- (g) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, kryen paradhenie;
- (h) mund të lejojë vendosjen e moratoriumit kundër debitoreve të shoqërisë; mund të terhiqet nga kërkesat ligjore që rrjedhin nga marrëdhëniet e shoqërisë me palët e treta;
- (i) Punësimin dhe përjashtimit e stafit të shoqërisë, si dhe percaktimin e rrogave të pagesave si dhe shperblimeve për personelin.
- (j) Marrjen e masave për mbrojtjen e interesave të shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të percaktojnë avokatë të ndryshëm për të mbrojtur interesat e shoqërisë dhe të vendosë masën e shperblimit të tyre; administratori mund të depozitojë ankesa dhe të terhiqet prej tyre, të nënshkruajë marrëveshje gjyqësore, të kryejë marrëveshje arbitrazhi, të caktojë

arbitër, të tërheqe ankesa te depozituara nga shoqëria dhe te nderprese vazhdimin e tyre.

- (k) administratori ka të drejtë të marrë cdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- (l) Kryerjen e shpenzimeve të nevojshme për të përballuar aktivitetin e përditshëm të Shoqërisë;
- (m) administratori është përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;
- (n) administratori është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë.
- (o) thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
- (p) publikimin e njoftimeve të nevojshme duke përfshirë publikimin e pasqyrave vjetore financiare
- (q) administratori është përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
- (r) marrin vendime mbi të gjitha çështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme.

12.7 Administratori do të emerohet për një periudhë kohore jo më të gjatë se 5 vjet. Mandati i administratorit mund të rinovohet me vendim të ortakut.

### **Neni 13**

#### **Pasqyrat financiare.**

Pasqyrat financiare miratohen nga Ortaku i vetëm dhe dorëzohen pranë institucioneve përgjegjëse brenda afateve të përcaktuara në ligj.

### **Neni 14**

#### **Viti financiar**

Viti financiar i Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, duke filluar që më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

Si përjashtim vetëm viti i parë financiar i Shoqërisë fillon më datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 Dhjetor 2022.

### **Neni 15**

#### **Pagesa e dividendëve**

Shoqëria do t'i shpërndajë Ortakëve të gjitha përfitimet e disponueshme, pas përmbushjes së të gjitha detyrimeve ligjore dhe të rezervave si dhe në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar.

### **Neni 16**

## **Likuidimi i Shoqërisë**

16.1 Likuidimi i Shoqërisë bëhet me vendim të Ortakut të vetëm.

16.2 Një likuidator ose një grup likuidatorësh do të emërohen për marrjen e procedurave të likuidimit.

16.3 Likuidatori(ët) do të përgatisë raportin e likuidimit icili përmban (por nuk kufizohet me): gjendjen e përgjithshme ekonomike të Shoqërisë, fazat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për përfundimin e tij. Në fund të procesit, Asambleja do të rishikojë deklaratat financiare përfundimtare dhe do të miratojë mbylljen e procedurës së likuidimit.

## **Neni 17**

### **Dispozita perfundimtare**

Çdo çështje që nuk parashikohet në këtë statut do të zgjidhet ne përputhje me legjislacioni përkatës shqiptar për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare.

Çdo mosmarreveshje e cila mund të lindë gjatë aktivitetit të shoqërisë me pale të treta, do të zgjidhet pranë gjykatave kompetente shqiptare.

Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen me Vendim të Ortakut të Vetëm në përputhje me legjislacionin përkatës

Nënshkruar sot më 07/08/2022

**Ortaku i vetëm**

***Znj. Borana Vangjeli***